

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit J.M. nga ..., për shkak të veprës penale **Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme**, nga neni 259 A të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Komunale në Gjiilan, PP. nr.1588/2008, të datës 24.07.2008, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 21.11.2017, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 30.11.2017, përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari J.M., nga babai A. dhe nëna H. e lindur S., i lindur më datë ... në fsh. ...., K. e ..., jeton në ..., në rr. " ... " nr. ..., i martuar, baba i shtatë fëmijëve, pensionist, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar deri më tani, dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datën 17.07.2006, në rrugën e Prishtinës, nr. ..., " ... " në ..., është konstatuar se ka pushtuar në mënyrë të kundërligjshme pronën e paluajtshme të të dëmtuarit Kuvendi Komunal në Gjiilan, në atë mënyrë që ngastrën kadastrale ..., e cila evidentohet sipas fletave poseduese nr. ..., ZK-Gjiilan, me kulturë rrugë, në sipërfaqe prej 11 m 2, në emër të pasurisë shtetërore të KK-së Gjiilan, ka ndërtuar murin me material të fortë dhe është pasuruar pa bazë juridike,

-me çka ka kryer veprë penale **Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme**, nga neni 259 A KPK-së, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

## E G J Y K O N M E D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarin J.M., me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 muajsh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në kohën prej **1(një) viti**, nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë, si dhe me

Obliohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 511/2016, të datës 22.03.2016, kundër të akuzuarit H.Sh., për shkak të veprës penale Ndryshimi i Njehsorit të Shërbimeve, nga neni 323 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurorja Leonora Shemsiu-Kadriu, në fund të procedurës deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues dhe me vetë pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit F.T., nuk është kontestues se i akuzuari e ka kryer këtë veprë penale dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim meritator sipas ligjit, ndërsa, përkitazi me lartësinë dhe llojin e dënimit, gjykata t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, e më pastaj, të akuzuarit t'ia shqiptojë sanksionin adekuat penal, në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit dhe kjo të jetë preventivë për të akuzuarin që në të ardhmen mos të kryejë vepra të ngjashme.

*I akuzuari H.Sh., në fund të procedurës deklaroi se i vjen keq për veprën e kryer penale, është penduar për këtë, premtori se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, andaj, kërkoi nga gjykata t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari H.Sh., e ka kryer veprën penale Ndryshimi i Njehsorit të Shërbimeve nga **neni 323** të KPRK-së.*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysht rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht fajsinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, pendimi i tij, si dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.  
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 511/16, më datë 29.09.2017**

**Praktikantja,**  
Xhevahire Elezi

**Gjykatësja e vetme gjykuese,**  
Luljete Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.